


Pasqyra mbi modelin intervenues



KANTON
NIDWALDEN

BILDUNGSDIREKTION

AMT FÜR VOLKSSCHULEN

SJELLJA ME PROBLEMET DISIPLINORE

1 Hyrje

Aktuale

Në shkollat publike po shpeshtohen problemet disiplinore. Ndryshimet shoqërore kanë çuar në një ndryshim të vlerave, i cili ndikon edhe në sjelljen e fëmijëve dhe të rinjve në lëminë e shkollës. Mospërfilljen (lëni-en pas dore) të edukimit shkolla nuk mund ta kompenzojë, aq sa nuk mund të korigjojë as zhvillimet e gabuara ekonomike. Në anën tjetër shkolla përpiqet të ndihmojë prindërit në edukimin e fëmijëve të tyre, në rastet konfliktuale të reagojë me maturi dhe në mënyrë kompetente dhe t'iu ofrojë nxënësve të zellshëm mundësisht një klimë të mirë dhe të papenguar të punës.

Aspekte të problematikës disiplinore

Nën problemet disiplinore në shkollë kuptohen cenimet e ndryshme. Përtypja e çamçakëzit dhe përshpëritja, çilimillëqet dhe pavëmendshmëria numërohen gjithashtu sikur vandalizmi dhe dhuna. E përbashkët e gjithë kësaj mënyre të sjelljes është vetëm një: të pengojnë të përditshmen shkollore, të provokojnë mësimdhënësit dhe të pengojnë nxënësit dhe nxënëset në mësimin e tyre.

Transparenca

Fletënjoftimi i bashkangjitur duhet t'iu tregojë prindërve se si merret shkolla me problemet disiplinore. Në qendër të vëmendjes është një veprim, i cili parasheh katër faza me shtimin e masave të rëndësishme.

2 Detyrë (porosi) nga shkolla, prindërit ndhe mësimdhënësit

<i>Parimi</i>	Si parim duhet të vlejë: nuk do të tolerohen dhuna dhe kërcënimi me dhunë. Këtë qëndrim shkollat duhet t'ua bëjnë të qartë pa keqkuptime si brenda ashtu edhe jashtë shkollës.
<i>Përgjegjësia e përbashkët</i>	Shpesh prindërit dhe shkolla lidhur me vështirësitë disiplinore ua he-dhin fajin njëri tjetrit. Mirëpo prindërit dhe mësimdhënësit bartin bashkarisht përgjegjësinë për atë, që fëmija të përcillet në mënyrë optimale në mësim. Ata krijojnë me këtë një lloj ekepe të ndihmës (përkrahjes).
<i>Shkolla dhe plani disiplinor</i>	Disiplina nuk është vetëm çështje e mësimdhënësve të veçantë, por duhet të kuptohet si një detyrë e gjithë shkollës. Përpunimi i një plani bartës disiplinor nga të gjithë pjesëmarrësit në shkollë është detyrë e çdo shkolle. Kjo kushtëzon një proces të vazhdueshëm të zhvillimit shkollor.
<i>Parandalimi</i>	Për një punë pa fërkime në shkollë është e rëndësishme që mësimdhënësit, nxënësit, nxënëset ta ndjejnë veten fizikisht dhe psikikisht mirë. Një parakusht nga ana e shtëpisë së prindërve qëndron në atë, që fëmijët të vijnë në shkollë të pushuar dhe të çlodhur. Është me vlerë që prindërit t'ua bëjnë të qartë fëmijëve të tyre se ata i japin rëndësi të madhe mësimi dhe shkollës.

3 Fusha e përgjegjësisë së prindërve

<i>Koha e lirë jashtëshkollore</i>	Mbikqyrja në kohën e lirë jashtëshkollore është detyrë e prindërve. Këtyre u takon edhe udha për në shkollë (VSG ¹ Art. 56) dhe qëndrimi në oborrin e shkollës gjatë kohës së lirë.
<i>Shkollimi</i>	Prindërit dhe personi i tretë, të cilëve u është besuar nxënësi ose nxënësja, janë përgjegjës sipas ligjit të shkollës publike (VSG Art.60) për vijimin e shkollimit.

4 Modeli intervenues në katër hapa (faza).

<i>Procesverbali; transparenca</i>	Lidhur me rastin do të zhvillohet një bisedë, ku është e rëndësishme që nga fillimi i bisedës të mbahet procesverbali. Në një procesverbal të tillë do të shënohen kush çfarë ka thënë për secilën temë; pas bisedës të gjithë të pranishmit do ta lexojnë dhe do ta nënshkruajnë. Nëse nënshkrimi refuzohet, kjo duhet të shënohet bashkë me arsyet.
<i>Dëgjimi ligjor</i>	Më së voni nga faza e tretë udhëheqësia shkollore, gjegjësisht organet shkollore janë të obliguara të udhëzojnë prindërit për mundësinë e marrjes së qëndrimit me shkrim para zbatimit të masave të paraqitura (ngritura). Edhe nxënësit ose nxënëset së goditur duhet dhënë mu-ndësia për t'u shprehur për masat e parapara.
<i>Përfshirja e udhëheqësisë së shkollës</i>	Udhëheqësia e shkollës është pjesëmarrëse në proces që nga faza e tretë, por mund të përfshihet edhe më heret për këshillim.
<i>Përfshirja e qendrave të specializuara</i>	Përfshirja e shërbimit shkollor psikologjik ² ose e ndonjë qendre tjetër kantonale të specializuar ³ mund të jetë e plotëkuptimtë pavarësisht nga faza e vijuese e procesit. Këtu duhet pasur parasysh që t'iu përmbahet ruajtjes së të dhënave.
<i>Renditja kohore</i>	Nëse nuk bëhen përmirësime pas fillimit të një faze të procesit, duhet të fillojë pas dy deri tre javë faza vijuese; nëse situata e kërkon një gjë të tillë, atëherë fazat e veçanta mund të shkurtohen.
<i>Grafiku</i>	Në anën e prapme gjendet modeli i intervenimit me fazat e saja të veçanta dhe masat shoqëruese të paraqitura grafikisht.

Fleta e paluar botohet nga Drejtoria për Arsim dhe Edukim për Nidwalden, botim i vitit 2003

Ekzemplarë të tjerë mund të merren në: Bildungsdirektion Nidwalden, Marktgasse 3, 6371 Stans, Tel. 041 – 618 74 01 ose në internet e dhënë si pdf në adresën: www.nw.ch

¹ Ligji për shkolla publike NG 312.1 nga 17. prilli 2002

² Shërbimi psikologjik shkollor / Marktgasse 3 / 6371 Stans / 041-618 74 10

³ - Këshillimorja për të rinj dhe prindër / Rathausplatz 9 / 6371 Stans / 041-618 75 70
- Këshillimorja për çështje të veseve / Rathausplatz 9 / 6371 Stans / 041-618 76 03